



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 238

Tiranë – E hënë, 12 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 622, datë 11.11.2016	Për miratimin e modelit të adresës dhe radhën e vendosjes së elementeve të saj..... 24339
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 47, datë 5.12.2016	Për disa ndryshime në vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 25, datë 18.4.2016..... 24341
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 51, datë 5.12.2016	Për disa ndryshime në vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 44, datë 19.9.2016..... 24343
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 55, datë 5.12.2016	Për shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve, nga granti 1, “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I..... 24346
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 57, datë 5.12.2016	Për shpalljen e thirrjes për projektide, granti 1, “Shqipëria dixhitale”, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III..... 24352



UDHËZIM

Nr. 622, datë 11.11.2016

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË
ADRESËS DHE RADHËN E VENDOSJES
SË ELEMENTEVE TË SAJ**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr. 89/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, me qëllim zbatimin e një procesi unik të pasqyrimin të adresës, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Elementet e adresës do të shkruhen sipas kësaj radhe:

- emri i bulevardit/ rrugës/ rrugicës/ sheshit ose parkut;
- numri i ndërtesës “Nd”, numri i hyrjes “H”, numri i apartamentit “Ap”;
- emri i qytetit/fshatit, emri i njësisë administrative, kodi postar;
- emri i bashkisë.

Në çdo rast emri i rrugës, si dhe emrat e bashkisë dhe njësive administrative, shkruhen me

a) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën në Bashkinë Tiranë:

Rr. “MYSLYM SHYRI”

Nd.5, H.2, Ap.12

Njësia Administrative Nr.10, 1001

TIRANË

Rr. “MYSLYM SHYRI”

Nd.5; H.2; Ap.12

Njësia Administrative Nr.10; 1001

TIRANË

b) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën ku qyteti dhe njësia administrative është me emër të njëjtë me bashkinë:

Rr. “JANI VRUHO”

Nd.5, H.2, Ap.12

5003

BERAT

Rr. “JANI VRUHO”

Nd.5; H.2; Ap.12

5003

BERAT

c) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën ku qyteti dhe njësia administrative është me emër të njëjtë, por me emër të ndryshëm me bashkinë:

Rr. “AGIM RAMADANI”

Nd.10, H.2, Ap.12

BAJRAM CURRI, 8702

TROPOJË

Rr. “AGIM RAMADANI”

Nd.10; H.2; Ap.12

BAJRAM CURRI; 8702

TROPOJË

germa të mëdha. Nëse ka shkurtime pas tyre vendoset “.”.

2. Elementet për ndërtesën, hyrjen dhe apartamentin do të shkruhen në një rresht dhe do të ndahen ndërmjet tyre me shenjën “,” ose “;”.

Në rastet kur mungon numri i hyrjes së ndërtesës dhe numri i apartamentit do të thotë se ndërtesa ka përkatësisht një hyrje dhe hyrja ka vetëm një apartament. Në këtë rast do të shkruhet vetëm numri i ndërtesës.

Në rastet kur mungon numri i apartamentit do të thotë se ndërtesa ka përkatësisht një hyrje dhe hyrja ka vetëm një apartament. Në këtë rast do të shkruhet numri i ndërtesës dhe numri i hyrjes.

3. Emrat që përcaktojnë elementet fshat/qytet/njësi administrative dhe kodi postar, do të shkruhen në një rresht, të ndarë midis tyre me shenjën “,” dhe “;”.

4. Emri i Bashkisë do të shkruhet në rreshtin e fundit në rastet kur kemi adresë brenda vendit dhe kur kemi adresë për jashtë vendit do të shtohet dhe emri i shtetit në të njëjtin rresht me emrin e bashkisë të ndarë midis tyre me shenjën “,” dhe “;”.

5. Modeli i shkrimit do të jetë sipas rasteve të mëposhtme:



d) Në rastet kur njësia administrative ka emër të ndryshëm nga bashkia:

Rr. “DELIALLISI”

Nd.46, H.1, Ap.3

SUKTH, 2010

DURRËS

Rr. “DELIALLISI”

Nd.46; H.1; Ap.3

SUKTH; 2010

DURRËS

Rr. “KOSOVA”

Nd.23, H.1, Ap.3

LAÇ, 4701

KURBIN

Rr. “KOSOVA”

Nd.23; H.1; Ap.3

LAÇ; 4701

KURBIN

e) Në rastet e një fshati me emër të ndryshëm nga emri i bashkisë dhe i njësisë administrative:

Rr. “AVNI BAJRAMI”

Nd.24, H.1, Ap.3

Sheqeras, VRESHTAS, 7028

MALIQ

Rr. “AVNI BAJRAMI”

Nd.24; H.1; Ap.3

Sheqeras; VRESHTAS; 7028

MALIQ

f) Në rastet e fshatrave me emër të njëjtë me emrin e njësisë administrative:

Rr. “LISIT”

Nd.12, H.1, Ap.5

VRESHTAS, 7028

MALIQ

Rr. “LISIT”

Nd. 12, H.1, Ap.5

VRESHTAS; 7028

MALIQ

g) Kur ndërtesat janë të përbëra nga lagje, numërtimi i ndërtesave do të bëhet sipas lagjeve, të cilat më parë duhet të marrin një emër. Emri i lagjes do të zëvendësojë emrin e rrugës edhe në adresë.

Lagja GROPAS

Nd.1, H.2, Ap.4

Mucaj, REMAS, 9004

DIVJAKË

Lagja GROPAS

Nd.1; H.2; Ap.4

Mucaj; REMAS; 9004

DIVJAKË.

h) Kur në fshat nuk mund të emërtojmë rrugët dhe ndërtesat klasifikohen si një grup i vetëm i përbashkët, atëherë nuk shkruhet emri i rrugës.

Nd.2, H.1, Ap.4

Drithas, SHUSHICË, 9406

VLORE

Nd.2; H.1; Ap.4

Drithas; SHUSHICË; 9406

VLORE

6. Të gjitha institucionet publike/private, personat juridikë e fizikë zbatojnë modelin e adresës në çdo format zyrtar që kërkohet. Kryetarët e bashkive u dërgojnë të gjitha institucioneve publike/private, të gjithë personave juridikë dhe fizikë adresën përkatëse, si dhe lajmërimin sa herë që ajo ndryshohet;

7. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Saimir Tahiri

**VENDIM****Nr. 47, datë 5.12.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE NR. 25, DATË 18.4.2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 25, datë 18.4.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grandit “Arsimi” thirrja e parë, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri
Ministri i Financave
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Ministri i Zhvillimit Urban
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës
Ministri i Arsimit dhe Sportit
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të Ujërave
Ministri i Shëndetësisë
Ministri i Kulturës
Ministri i Mjedisit
Ministri i Punëve të Brendshme
Ministri i Shtetit për Inovacionin
dhe Administratën Publike
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar.

Tabela 1. . Lista e projekteve të arsimit, me cikël financimi 2016-2017, me reduktim apo shtesë financimi për vitin 2016, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, dhe saktësim të vlerës së mbetur të financimit për vitin 2017, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla II.

Tabela 1, e vendimit nr.25, datë 18.4.2016, e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, zëvendësohet me tabelën si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e kontratës (Lekë)	Vlera e financimit e miratuar për vitin 2016 (Lekë)	Fonde që i reduktohen financimit të vitit 2016 (Lekë)	Fonde që i shtohen financimit të vitit 2016 (Lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017 (Lekë)
QARKU BERAT								
1	Bashkia Ura Vajgurore	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Andrea Mbrice", Poshnje	54 685 184	53 037 223	27 342 592		25 694 631	0
QARKU DIBËR								
2	Bashkia Bulqizë	Rikonstruksioni i shkollave të Njësise Administrative Shupenzë	87 170 894	86 808 744	43 585 447		15 000 000	28 223 297
QARKU DURRËS								
3	Bashkia Shijak	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare fshati Shtrazë, Gjepalaj	46 220 996	46 145 342	23 110 498		23 034 844	0
4	Bashkia Durrës	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Marie Kaculini", Durrës	143 959 125		71 979 563	35 000 000		106 979 562
QARKU ELBASAN								
5	Bashkia Elbasan	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Qamil Guranjaku"	65 598 953	65 448 856	32 799 477		15 000 000	17 649 379
6	Bashkia Librazhd	Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve nr.2, Qyteti Librazhd	8 800 000	8 763 720	4 400 000		4 363 720	0



7	Bashkia Cërrik	Ndërtimi i shkollës, ndërtimi i palestrës, terrene sportive dhe sistemin i territorit të shkollës 9-vjeçare "Adem Elmaz Asllani" Shtëpanjë, Njësia Administrative Gostime	73 073 515	72 948 120	36 536 758	20 000 000	16 411 362
QARKU GJIROKASTËR							
8	Bashkia Tepelenë	Rikonstruksioni i plotë i shkollës së mesme të përgjithshme "Abaz Shehu", Tepelenë	64 228 054	55 781 695	32 114 027	13 667 668	10 000 000
9	Bashkia Memaliaj	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Nimete Progonati" Memaliaj	35 924 340	19 706 870	17 962 170	1 744 700	0
QARKU KORÇË							
10	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i kopshit nr.11 Korçë	10 400 000	6 677 309	5 200 000	1 477 309	0
QARKU SHKODËR							
11	Bashkia Vau i Dejës	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Don Martin Trushi" Stajkë, Komuna Bushat	72 132 616	71 404 288	36 066 308	25 000 000	10 337 980
QARKU VLORË							
12	Bashkia Vlorë	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Ali Demi", Vlorë	199 475 379		93 237 690	45 801 092	152 038 781
13	Bashkia Konispol	Rikonstruksion+ ndërtim palestere e shkollës së bashkuar "Bejdo Sejko", Konispol	80 379 965	80 287 992	40 189 983	40 098 009	0
TOTALI			942 049 021	567 010 159	464 524 513	80 801 092	185 080 881
							341 640 361

Shënim:

1. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
2. "Fonde që i reduktohen financimit për vitin 2016", tregon vlerën e fondit që reduktohet, nga financimi i miratuar deri tani, me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, për objektet që kanë ecuri faktike punimesh, më pak se vlera e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016. Kjo vlerë do të planifikohet për financim në vitin 2017. Vlera e reduktimit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresën nr.11191 prot, datë 4.11.2016.
3. "Fonde që i shtohen financimit për vitin 2016", tregon vlerën e fondit që shtohet mbi financimin e miratuar deri tani me vendime të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, gjatë vitit 2016, për objektet që kanë ecuri faktike punimesh më shumë se vlera e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016. Kjo vlerë pakëson vlerën e mbetur për financim në vitin 2017. Vlera që shtohet përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresën nr. 11191 prot, datë 4.11.2016.
4. "Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017", tregon vlerën e mbetur të financimit pas diferencës midis vlerës së kontratës, vlerës së financimit të realizuar në vitin 2016, dhe vlerës së reduktuar/shtuar me këtë vendim, sipas realizimit në fund të vitit buxhetor 2016.



VENDIM
Nr. 51 , datë 5.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE NR. 44, DATË 19.9.2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 44, datë 19.9.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për grantin e financimit të projekteve të reja, “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, thirrja III, për vitin 2016, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të financuara, me cikël financimi 2016-2017 përmes grantit 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, për vitin 2016.

Tabela 1, të vendimit nr.44, datë 19.9.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, zëvendësohet me tabelën si më poshtë vijon:

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Nr. i vendimit të KZHR-së	Vlera e plotë e projektit (në Lekë)	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Vlera e “kursyer” pas lidhjes së kontratës (në Lekë)	Vlera e financimit e vitit 2016 (e reduktuar) (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në Lekë)
QARKU BERAT								
1	Bashkia Poliçan	Rehabilitimi i shëtitores Miqësia	nr.10, datë 10.3.2016	27 546 411	27 488 376	58 035	13 715 170	13 773 206
2	Bashkia Skrapar	Rikualifikimi i hapësirave përreth pallatit të kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasha Hysi”, rruga automobilistike “Pasha Hysi”	nr.10, datë 10.3.2016	265 427 536	264 704 108	723 428	131 990 340	132 713 768
3	Bashkia Ura Vajguore	Rehabilitimi urban i zonës përgjatë lumit Osum, Loti 1	nr.10, datë 10.3.2016	179 989 500	131 908 092	48 081 408	41 913 342	89 994 750
QARKU DIBËR								
4	Bashkia Dibër	Rinovim i infrastrukturës së bulevardit “Elez isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”	nr.10, datë 10.3.2016	110 726 698	104 789 063	5 937 635	49 425 714	55 363 349



5	Bashkia Dibër	Përmirësimi i infrastrukturës vendore dhe rivitalizim i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës	nr.10, datë 10.3.2016	207 649 090	207 506 697	142 393	103 682 152	103 824 545
QARKU DURRËS								
6	Bashkia Shijak	Rikualifikim i sheshit tek lagjia "Lugina"	nr.31, datë 13.6.2016	25 202 594	25 093 368	109 226	12 492 071	12 601 297
7	Bashkia Krujë	Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit	nr.10, datë 10.3.2016	366 281 871	364 453 272	1 828 599	181 312 336	183 140 936
QARKU ELBASAN								
8	Bashkia Belsh	Projekti i Ansambllit Rilindja, Belsh	nr.10, datë 10.3.2016	180 801 690	179 957 360	844 330	89 556 515	90 400 845
9	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i rrugës rurale Qaf Hajdaran - Byshek	nr.10, datë 10.3.2016	183 168 845	181 222 161	1 946 684	89 637 738	91 584 423
10	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugës "28 Nëntori"	nr.10, datë 10.3.2016	194 988 741	190 995 623	3 993 118	93 501 252	97 494 371
11	Bashkia Peqin	Ura e fshatit Grykësh, Njesia Administrative Pajove, Bashkia Peqin	nr.10, datë 10.3.2016	3 840 680	3 571 337	269 343	1 650 997	1 920 340
QARKU FIER								
12	Bashkia Divjakë	Segmenti 3 i Pasarelës+Urë në dru përgjate rrugës automobilistike, Hyrje Parkut-Godulla e Brendeshme	nr.10, datë 10.3.2016	102 130 235	99 495 414	2 634 821	48 430 296	51 065 118
13	Bashkia Fier	Ndërtim i parkut qendror të qytetit, rehabilitim i rrugës "Xoxi Andoni" dhe hapësirat rreth saj	nr.10, datë 10.3.2016	300 126 792	298 786 258	1 340 534	148 722 862	150 063 396
14	Bashkia Fier	Rivitalizim i parkut pranë bar Rinisë dhe rehabilitim i rrugës "Dervish Hekali"	nr.10, datë 10.3.2016	147 498 882	143 730 840	3 768 042	69 981 399	73 749 441
15	Bashkia Lushnje	Rotondo e Plugut-Postoblok, rruga e hyrjes Lushnjë-Tiranë, (faza e dytë)	nr.10, datë 10.3.2016	106 224 781	102 989 042	3 235 739	49 876 651	53 112 391
16	Bashkia Patos	Shetitore "Republika"	nr.10, datë 10.03.2016	98 615 048	96 285 666	2 329 382	46 978 142	49 307 524
17	Bashkia Patos	Ndërtimi i rrugës Ruzhdië - Gjinoqar	nr.10, datë 10.3.2016	66 213 456	37 003 000	29 210 456	3 896 272	33 106 728
18	Bashkia Roskovec	Projekt zhvillimor për fshatin Kuman	nr.31, datë 13.6.2016	30 548 315	28 800 000	1 748 315	13 525 842	15 274 158
19	Bashkia Roskovec	Sistemim , asfaltim i rruges së fshatit Kurjan	nr.31, datë 13.6.2016	148 286 386	143 835 890	4 450 496	69 692 697	74 143 193
QARKU GJIROKASTËR								
20	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve në Gjirokastrë	nr.10, datë 10.3.2016	99 755 007	58 220 247	41 534 760	8 342 743	49 877 504
21	Bashkia Këlcyrë	Rikualifikim urban përreth përroit në lagjen "Gun" si edhe sistemim i shtratit të përroit	nr.10, date 10.03.2016	67 810 604	67 757 108	53 496	33 851 806	33 905 302



22	Bashkia Memaliaj	Projekti i Ansambllit Arkitektonik të sheshit Minatori, Memaliaj	nr.10, datë 10.3.2016	151 350 288	98 683 679	52 666 609	23 008 535	75 675 144
23	Bashkia Tepelenë	Hyrya Ali Pasha vazhdimi i shetitores përgjatë kalasë	nr.31, datë 13.6.2016	149 984 392	147 599 953	2 384 439	72 607 757	74 992 196
QARKU KORÇË								
24	Bashkia Devoll	Rikualifikim urban i qendrës së Qytetit Bilisht, Lati 1	nr.10, datë 10.3.2016	124 315 222	123 043 330	1 271 892	60 885 719	62 157 611
25	Bashkia Kolonjë	Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit "Rilindja" Ersekë	nr. 10, datë 10.03.2016	51 858 597	51 132 805	725 792	25 203 506	25 929 299
26	Bashkia Korçë	Restaurimi i objekteve të pazarit Korçë Lote 2	nr.10, datë 10.3.2016	167 166 000	162 438 077	4 727 923	78 855 077	83 583 000
27	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i qendrës dhe infrastrukturës rrugore dhe monumenteve të kulturës, Voskopojë	nr.10, datë 10.3.2016	370 000 000	362 983 320	7 016 680	177 983 320	185 000 000
28	Bashkia Korçë	Rikualifikim urban i zones perreth qytezes se femijeve Korce	nr.31, datë 13.6.2016	396,195,200	368,063,408	28,131,792	169,965,808	198,097,600
29	Bashkia Maliq	Rehabilitim rruga hyrese "Pylli i Fazaneve"	nr.10, datë 10.3.2016	28 071 408	17 296 544	10 774 864	3 260 840	14 035 704
QARKU KUKËS								
30	Bashkia Has	Rehabilitimi i godinave, shesheve dhe qendrës së qytetit Krumë-Has	nr.10, datë 10.3.2016	106 997 427	103 390 324	3 607 103	49 891 610	53 498 714
31	Bashkia Tropojë	Shëtitorja e qytetit Bajram Curri/	nr.31, datë 13.6.2016	149 270 311	114 949 590	34 320 721	40 314 434	74 635 156
32	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Bajram Curri - Vernice	nr.10, datë 10.3.2016	65 376 393	41 873 880	23 502 513	9 185 683	32 688 197
QARKU LEZHË								
33	Bashkia Lezhë	Lulishte dhe parkimi përballë gjimnazit "Hydajet Lezha", lagjia "Beselidhe"	nr.10, datë 10.3.2016	25 200 932	21 924 252	3 276 680	9 323 786	12 600 466
34	Bashkia Mirditë	Rikualifikimi urban i sheshit të qytetit Rrëshen	nr.10, datë 10.3.2016	186 901 843	172 020 124	14 881 719	78 569 202	93 450 922
QARKU SHKODËR								
35	Bashkia Pukë	Sistemi i lagjes pas pallatit të kulturës	nr.10, datë 10.3.2016	28 390 307	27 659 507	730 800	13 464 353	14 195 154
36	Bashkia Shkodër	Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Xhabije"	nr.10, datë 10.3.2016	76 654 597	46 519 616	30 134 981	8 192 317	38 327 299
QARKU TIRANË								
37	Bashkia Kavajë	Rehabilitimi i përroit Leshniq, Kavajë	nr.10, datë 10.3.2016	450 000 000	446 006 592	3 993 408	221 006 592	225 000 000
38	Bashkia Rrogozhinë	Rivitalizimi urban i qendrës së qytetit të Rrogozhinës	nr.31, datë 13.6.2016	149 996 829	149 983 775	13 054	74 985 360	74 998 415
39	Bashkia Tiranë	Rikualifikimi urban i Sheshit Skënderbej, Faza e I	nr.31, datë 13.6.2016	640 084 160	633 043 125	7 041 035	313 001 045	320 042 080
40	Bashkia Vorë	Sistemi asfaltim rruge lidhëse urbane Fushë Preze Ura e Limuthit - Bërxulle - Bashkia Vorre	nr.31, datë 13.6.2016	149 243 886	148 943 867	300 019	74 321 924	74 621 943
QARKU VLORË								
41	Bashkia Himarë	Rikualifikim urban i sheshit Borsh	nr.10, datë 10.3.2016	26 467 315	26 133 332	333 983	12 899 674	13 233 658



42	Bashkia Himare	Rikualifikim urban i sheshit Lukovë	nr.10, datë 10.3.2016	89 461 945	83 999 999	5 461 946	39 269 026	44 730 973
43	Bashkia Sarandë	Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e flamurit	nr.10, datë 10.3.2016	105 643 979	102 518 468	3 125 511	49 696 478	52 821 990
44	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim asfaltim i rrugës së Unazës Vlorë (Poliklinka 7_Pallatit)	nr.10, datë 10.3.2016	582 999 971	416 132 539	166 867 432	124 632 553	291 499 986
TOTALI				7 184 464 164	6 624 933 029	559 531 135	3 032 700 937	3 592 232 092

Shënim:

1. “Vlera e projektit”, është vlera e kërkuar në aplikim nga autoriteti kontraktues, për t’u alokuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për zbatimin e projektit dhe e miratuar nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve. Kjo vlerë korrektohet nga vlera e kontratës, pas nënshkrimit të saj. Fondi i përfituar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, dhe shpërndahet, për financimin e projekteve të reja dhe/ose në vazhdim. Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
2. “Vlera e kontratës”, përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
3. “Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës”, përfaqëson vlerën e përftuar nga diferenca midis vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës. Fondi i krijuar nga kjo diferencë i shtohet fondit të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, dhe shpërndahet për financimin e projekteve të reja në thirrjen e radhës dhe/ose në vazhdim të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.
4. “Vlera e financimit e vitit 2016 (e reduktuar)”, tregon financimin e dhënë në vitin 2016, dhe reflekton zbritjen e vlerës së kursyer, pas lidhjes së kontratës.
5. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2017”, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit të alokuar në vitin 2016 (e reduktuar).

VENDIM**Nr. 55, datë 5.12.2016**

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE, NGA
GRANTI 1, “INFRASTRUKTURA
VENDORE DHE RAJONALE”,
PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës

vendore dhe rajonale, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve;

1.2 Drejtimit e thirrjes për financim janë për:

a) projekte që shërbejnë si katalizator i rivitalizimit të qytetit, përmes jetëzimit të hapësirave publike, shesheve dhe përmirësimit të aksesit e të lëvizshmërisë dhe të infrastrukturës rrugore, vendore dhe rajonale si dhe zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal.

2. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, si dhe nga Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, dhe nga Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, me marrëveshje partneriteti, të lidhur midis agjencisë dhe dy ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, sipas afatit dhe shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara kryhet nga sekretariati teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.



4. Shpalljen e kërkesës për dërgim projektidesh për t'u konsideruar në kuadrin e hartimit të drejtimeve për thirrje dhe programit operacional 2017. Dërgimi i projekteve bëhet nga propozuesit, sipas afatit dhe shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet ministri i Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeminstri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar;

Shtojca I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në "Fletoren zyrtare"	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte në grantin, programin dhe shtyllën e financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
19 Dhjetor	Aplikuesit sipas pikës 2, të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi <i>on-line</i> në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi <i>on-line</i> për FZHR-në https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 . Ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon: a) Shtylla 1 - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale", - granti 1: "Infrastruktura vendore dhe rajonale", sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, nuk dorëzohen dosjet e aplikimit por vetëm pranë sekretariatit teknik.
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuar sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim.
5 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

**Shtojca II:****FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET SI EDHE PËR PROJEKTIDE****Ky format plotësohet për të gjitha projektet dhe projektidetë**

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	
Shtylla e financimit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet. (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet. (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Granti i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin grant aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërrhyrjeve të reja (sistem ngrohjeje, mur rrethues etj.) në objektin ekzistues (nëse ka); - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nqs parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), nëse krijon vonesa në zbatimin e punimeve, krijon kosto shtesë (kosto e shpronësimit), kush e mbulon koston e shpronësimit, si edhe dokumentacioni përkatës.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se një projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërrhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet, nëse për këtë projekt aplikuesi parashikon dhe deklaron (në formular) se mbulon: - Koston për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësi e qeverisjes vendore	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, donatorë apo nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Financim nga donatorë (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e donacionit në monedhën lekë.



Financime të tjera (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Deklarime. (*)	Aplikanti deklaron se: - projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve; - Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit, dhe/ose të investimeve. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues siguron pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. - Janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përlllogaritjen e kostos dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike, etj. (*)	Projekti përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit - preventivin - argumentimin teknik - përlllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendndodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, në formë teksti
Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf
Pamje 3 dimensionale (*) i detyrueshem përveç programit “Shqipëria dixhitale”	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf

SHËNIM: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të bëhen:

- a) Aplikimi *on-line* në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi *on-line* për FZHR-në (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)

Ose

- b) Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik përkatës.

**Shtojca III:****KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM (Shtylla 1 e financimit: Zhvillimi vendor dhe rajonal)****A. Kriteret e vlerësimit teknik për projektet**

Këto kriteret përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi, **maksimalisht, me 100 pikë**. Kriteret 1, 2 dhe 3, detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

Kriteret për vlerësimin e projekteve që propozohen për financim, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter vlerësohet nga **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.
2. Përputhja me politikën, drejtimit e thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
3. Ndikimi i projektit në promovimin e potencialeve të qyteteve, përmirësimit të qendrave dhe jetës komunitare, lehtësimit të aksesit dhe ndërveprimit midis zonave urbane e rurale, ndërlidhjes rajonale, ndikimit në zhvillimin lokal dhe rajonal, përmirësimin e hapësirave publike, aksesit dhe infrastrukturës së lëvizjes, cilësisë së jetës etj. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 25 pikë**.
4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
5. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Ky kriter vlerësohet me **me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Ky kriter vlerësohet me **me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

SHËNIM – Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi teknik, ligjor, dhe financiar i projekteve, në zbatim të ligjit për buxhetin, dhe vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, kryhet nga sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në këtë shtojcë, bashkëlidhur vendimit.
2. Sekretariati teknik i paraqet Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, listën e plotë të projekteve që propozohen për financim, në përfundim të procesit të vlerësimit.
3. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në bashkëpunim me sekretariatit teknik, merr masat për organizimin e mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas komunikimit zyrtar të sekretariatit teknik.

**Shtojca IV:****FORMATI I PROPOZIMIT PËR PROJEKT-IDE****Ky format plotësohet për të gjitha projekt-ide të**

Propozuesi (*)	
Data e propozimit	
Titulli i projektidesë	
Shtylla e financimit	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet. (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Granti i projektidesë	Të përcaktohet në cilin grant mund të përfshihet projekt-ideja e propozuar (sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”)
Qëllimi dhe objektivat	- Përshkruani shkurtimisht qëllimin e projekt-idesë, problematikën që ajo adreson, si dhe argumentimin se si projekt-ideja u përgjigjet nevojave të identifikuara. - Listoni objektivat e mundshëm që synon të arrihen me realizimin e kësaj projekt-ideje.
Përshkrimi i projektidesë	Të bëhet përshkrim i përgjithshëm i projekt-idesë së propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e zonës të investimit të mundshëm (shoqëruar me hartë); - Përshkrimi i ndërhyrjeve të mundshme në zonën ku mund zbatohet projekti;
Koordinatat e projekt idesë	- Të jepen koordinatat e vendodhjes së projekt-idesë, sipas sistemit të gjeoreferencuar, në formë teksti,
Konteksti i zhvillimit rajonal dhe lokal	- Përshkruani nëse projektideja lidhet me projekte të tjera të financuara më parë nga FZHR-ja, dhe rëndësia komplementare e investimit. - Përshkruani lidhjen e projektidesë me strategjinë territoriale dhe të zhvillimit të njësisë vendore, dhe/ose rajonale (nëse ka). - Përshkruani nëse impakti i projektidesë është rajonal, lokal dhe ndikimin që ka në fuqizimin e zhvillimit të rajonit, dhe/ose zhvillimit lokal.
Grupet/Numri i përfituesve	Përshkruani grupet e synuara dhe numrin e përafërt të popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektidesë në total.
Rezultatet e pritshme	Përshkruani rezultatet e pritshme nga mundësia e realizimit të kësaj projektideje.
Kohëzgjatja e projektidesë	Jepni një kohë të mundshme të zbatimit të projekt-idesë së propozuar në rast financimi.
Kosto paraprake, e pritshme, e projektidesë	Jepni kostot paraprake të projektidesë, të ndara me dy zëra: - Kosto e hartimit të projektit teknik. - Kosto e mundshme e realizimit (përfshirë TVSH)
Bashkëfinancues	Në rast se projektideja ka mundësi të bashkëfinancohet nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, listoni bashkëfinancuesit e mundshëm.
Kostoja totale e projektidesë (përfshirë TVSH)	
Aplikimi për projektidetë sipas pikës 4, të këtij vendimi, si më sipër, ka afat datën 10 Janar 2017.	

SHËNIM – Qëllimi i kërkesës për projektide

1. Kërkesa për dërgim projektidesh, bëhet në kuadër të hartimit të programit operacional 2017 – 2018 si dhe përcaktimit të drejtimeve të financimit për vitin 2017
2. Propozues janë subjektet e përcaktuara në Aneksin 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, përkatësisht, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, dhe Agjencia për Zhvillimin



Ekonomik Rajonal, me marrëveshje partneriteti, të lidhur midis agjencisë dhe dy ose më shumë njësive të qeverisjes vendore.

3. Dërgimi i projektideve duhet të bëhet:

- c) Aplikimi *on-line* në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi *on-line* për FZHR-në (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)

Ose

- d) Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik përkatës.

VENDIM

Nr. 57, datë 5.12.2016

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR
PROJEKTIDE, GRANTI 1, “SHQIPËRIA
DIXHITALE”, PROGRAMI “SHQIPËRIA
DIXHITALE”, SHTYLLA III**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e kërkesës për dërgim projektidesh, granti “Shqipëria dixhitale” programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III, për t’u konsideruar në kuadrin e hartimit të drejtimeve për thirrje dhe programit operacional 2017.

2. Dërgimi i projektideve bëhet nga njësiti e qeverisjes vendore, si dhe nga Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, dhe nga Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, me marrëveshje partneriteti, të lidhur midis agjencisë dhe dy ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, sipas afatit të përcaktuar në formatin e shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI

Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Shtojcë I: FORMATI I PROPOZIMIT PËR PROJEKTIDE

Propozuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues
Data e propozimit (*)	
Titulli i projekt idesë (*)	
Personi përgjegjës për projektin	Emri dhe mbiemri, funksioni, numri i telefonit, numri i celularit, adresa email, adresa çeb.
Lloji/sektori i projekt idesë (*)	Granti “Shqipëria dixhitale, Programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla III
Koha e realizimit të projekt idesë (*)	
Cila është nevoja për këtë projektidesë (*)	Jepni një përshkrim të shkurtër të situatës ekzistuese dhe shtysat kryesore për këtë projektide, për shembull problemin që ju duhet të zgjidhni apo rrethanat që ju detyrojnë për të realizuar produktin e këtij projekti. Nevojat kryesore që shtyjnë përpara këtë projekt mund të kenë natyrë ‘strategjike’ ose ‘operacionale’, shembuj tipike janë: ▪ Nuk arrihen nivelet e kërkuar të shërbimit ▪ Rritje e kostove operacionale ▪ Ndryshimi në kërkesat e funksioneve apo detyrave ▪ Ndryshimet në legjislacion / rregulloret ▪ Ndryshime si pasojë e një programi të qeverisë / shërbime të reja ose të zgjeruara ▪ Infrastruktura e qytetit, konektiviteti Duhet të përshkruani situatën aktuale dhe, kur është e mundur, disa tregues të qartë të niveleve të performancës aktuale (p.sh., numri i aplikimeve të përpunuara në ditë, numri i kërkesave që ju përgjigjeni, infrastruktura për menaxhimin e të cilës propozohet zgjidhja modernizuese, etj), për të siguruar si fillim një bazë për matjen e përmirësimeve në të ardhmen.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Tregoni se çfarë ka për qëllim të përmbushë ky projekt. ▪ Cilat janë rezultatet apo përfitimet e pritura? Cilat janë rezultatet e pritura në fund të projektit? Objektivat duhet të jenë specifike, të arritshme, të rëndësishme dhe të orientuara mirë në kohë. ▪ Objektivat e specifikuar këtu do të formojnë bazën e vlerësimit të suksesit të përgjithshëm të projektit.
Grupet e interesit dhe numri i përfituesve (*)	Listoni të gjitha grupet kryesore të palëve të interesuara të cilat mund të preken nga projekti. Këtu përfshin grupe të tilla si: Institucioni/Bashkia (p.sh., stafi front-line, back-office, menaxhimi, etj) ▪ Pjesë të pushtetit vendor apo ndërlidhja me organizata të pushtetit qendror ▪ Qytetarët ▪ Bizneset ▪ Organizatat joqeveritare dhe grupe të veçanta të interesit ▪ Partnerët e sektorit
Zgjidhja që propozohet (*)	<u>Fushëveprimi i zgjidhjes së propozuar</u> Duhet të siguroheni që të ketë një përshkrim të përgjithshëm të asaj që projekti do të ofrojë, duke përfshirë (por jo i kufizuar) si më poshtë: ▪ Cilat funksione, procese, programe, shërbime, infrastruktura dhe sisteme informacioni, etj. përfshin projekti. ▪ Cilat procese do të rimodelohen, rregullohen ndryshe ose ndryshohen. ▪ Burime dhe palë të tjera të cilat do të përfshihen në punën për këtë projekt (objekte të veçanta, ndërfaqe, ministritë/institucionet, pushteti vendor apo grupe të tjera të përfshira). ▪ Jepni arsye të qartë për zgjedhjen që keni bërë duke rekomanduar këtë



	zgjidhje inovative dhe potencial modernizues dhe vecanti të idesë. - Përshkruani ndonjë nga praktikat më të mira apo kërkime të tjera që keni kryer në mbështetje të zgjidhjes së propozuar. <u>Teknologjia:</u> Identifikoni dhe përshkruani implikimet teknike që lidhen me zgjidhjen e propozuar. - Është prezent apo do të ndërtohet ndonjë sistem i ri? - Do të zëvendësojë ndonjë nga sistemet ekzistuese? Nëse po, kur? - Do të propozojë ndryshime në ndërfaqe apo zgjidhje teknike për lidhjen me sistemet e tjera?
Risqet dhe qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë të qartë cilat janë risqet për ekzekutimin e projektit, si dhe të përshkruhet qëndrueshmëria e projektit.
Vlerësimet për burimet, koston dhe kohën (*)	<u>Plani i punës dhe afatet kohore:</u> - Përfshini një përshkrim baze të fushave kryesore të punës, duke përmendur edhe piketa të nivelit të lartë së bashku me datat e synuara. - Afatet kohore për kur do të fillojë dhe parashikimi për fundin e projektit <u>Vlerësimi i koston:</u> Këtu përfshihen vlerësimet fillestare për angazhimet financiare (p.sh. shpenzimet e pritura për realizimin e projektit) - Burimet e informacioneve që janë marre parasysh për llogaritjen e vlerësimit paraprak të kostove. (p.sh., proceset e brendshme, ekspertë të fushave si dhe të menaxhimit, shpenzimet për testimin dhe trajnimin, menaxhimin e brendshëm të projektit, etj.) - Burimet në fushën e teknologjisë së informacionit që janë përgjegjëse për të ndihmuar institucionin që të identifikojë mundësitë për të adresuar nevojat e tyre funksionale, dhe për të siguruar vlerësimin e koston së lidhur me përdorimin e teknologjisë për të informatizuar procesin (p.sh., hardware, software, nevojat për zhvillim, sistemet inovative dhe teknologjike, etj.) <u>Burimet:</u> - Vlerësimet paraprake për burimet njerëzore dhe sasia e punës së nevojshme për të përfunduar projektin. - Duhet të përfshihen të dy kategoritë e burimeve si të brendshme dhe të jashtme, dhe vëmendje t'i kushtohet burimeve për menaxhimin e projektit.
Kostoja totale e projektit (përfshirë TVSH)	
Kontributi në rast bashkëfinancimi	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në modernizimin e shërbimeve apo përmirësimin e cilësisë së jetesës	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit, të pritshëm, të ndikimit në modernizimin e shërbimeve, përmirësimin e cilësisë së jetesës, zgjidhje të qyteteve inteligjente etj.
Aplikimi për projek-idetë sipas pikës 2, të këtij vendimi, si më sipër, ka afat datën 10 Janar 2017.	

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM: Dërgimi i projekteve, sipas afatit, bëhet si më poshtë vijon:

- Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku formati i aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike) ose
- On-line në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi on-line për FZHR-në <https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja Kristalina
Tiranë, 2016